

OUCH!

NË KËTË NUMËR..

- Sfondi
- Fjalëkalimet
- Verifikimi Dyhapësh

Verifikimi Dyhapësh

Sfondi

Procesi i vërtetimit të identitetit (i quajtur autentikim) është thelbësor për të mbrojtur informacionin personal. Kjo bëhet për të garantuar që vetëm ju të keni akses në informacionin që ju përket, pra e-mail, foto apo llogari bankare. Tri janë metodat për të vërtetuar identitetin: niseni nga çfarë dini - p.sh. fjalëkalimi, çfarë keni – p.sh. patentat e makinës, ose çfarë jeni – p.sh. gjurmë gishti. Secila metodë ka epërsitë dhe mangësitë e veta. Siç dihet, fjalëkalimi është mënyra më e përhapur. Ky shkrim ju mëson të mbroheni me një verifikim dyhapësh, që është shumë më e sigurt sesa fjalëkalimi dhe po aq e thjeshtë. Për të kuptuar më mirë verifikimin dyhapësh, duhet të analizojmë pak fjalëkalimet.

Botuesi i ftuar

Keith Palmgren ka mbi 30 vite përvojë me Sigurinë e Informacionit. Ai është instruktor i certifikuar nga Instituti SANS dhe autor i kursit pesëditor SANS SEC301 me titull “Hyrje në Sigurinë e Informacionit”. Përveç mësimdhënies, Keith merret edhe me konsulencë dhe hartim projektesh. Mund ta ndiqni Keith-in në [@kpalmgren](https://twitter.com/kpalmgren).

Fjalëkalimet

Fjalëkalimet vërtetojnë kush jeni mbi bazën e diçkaje që dini. Problemi me fjalëkalimet është se janë e vetmja mbrojtje. Nëse dikush e gjen apo zbulon fjalëkalimin tuaj, mund të arrijë të ketë akses në informacionin tuaj. Prandaj, gjithmonë këshillohen fjalëkalime të vështira për t’u gjetur; vendosni fjalëkalim i posaçëm për secilën llogari dhe të mos ua tregoni të tjerëve. Këto këshilla janë të vlefshme, por duhet thënë se fjalëkalimi po del mode, sepse nuk është më efikas në epokën moderne. Teknologjitë e fundit ua kanë lehtësuar shumë punën sulmuesve kibernetikë në zbërthimin e fjalëkalimeve. Çdo përdoruesi i duhet një metodë më e kollajtë dhe më e sigurt për të pasur autentikim “të fortë”. Fatmirësisht, kjo metodë ekziston dhe quhet “verifikimi dyhapësh”.

Verifikimi Dyhapësh

Verifikimi dyhapësh (ndonjëherë i quajtur edhe autentikimi me dy faktorë – 2FA) është më i sigurt sesa fjalëkalimi, sepse kërkon jo një, por dy metoda për të vërtetuar identitetin. Një shembull është karta e bankës (ATM); kur tërhiqni para nga bankomati, përdorni një formë verifikimi dyhapësh. Për të marrë paratë, ju duhen karta (që e keni) dhe numri PIN (që e dini).

Verifikimi Dyhapësh

Edhe po t'ju humbë karta, prapë paratë i keni të sigurta, se personi që e gjen nuk di PIN (në mos e keni shkruar në kartë, që do të ishte vërtet një ide e keqe). E njëjta vlen nëse dikush e di PIN-in, por nuk ka kartën. “Keqbërësi” duhet të ketë të dyja për t’u futur në llogarinë tuaj bankare. Pra, ky verifikim dyhapësh është më i sigurt, sepse kemi dy shtresa sigurie.

Përdorimi i Verifikimit Dyhapësh

Verifikimin dyhapësh e kryeni për çdo llogari, sepse, fatmirësisht, shumica e shërbimeve online e ofrojnë tashmë. Google është një nga pararojat e verifikimit dyhapësh. Llogaritë Google janë preja e parapëlqyer e sulmuesve kibernetikë, sepse iu ofrojnë shërbime online falas miliona njerëzve në mbarë botë. Si e tillë, Google duhej të forconte autentikimin dhe ishte ndër të parat organizata që futi verifikimin dyhapësh në shumicën e shërbimeve online.

Mjafton të kuptoni si funksionon verifikimi dyhapësh i Google, për të kuptuar si funksionon edhe për shumicën e siteve të tjera si Twitter, Facebook, Apple, Instagram dhe shumë banka.

Si fillim, aktivizoni verifikimin dyhapësh në llogarinë Google dhe regjistroni numrin e celularit. Pasi e plotësoni, verifikimi dyhapësh funksionon kështu. Futeni në llogari, si gjithmonë, me emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin. Ky është i pari nga dy faktorët – diçka që e dini. Pastaj, Google ju dërgon një SMS që përmban një kod unik, zakonisht me 6 shifra. Ashtu si fjalëkalimin, e fusni këtë numër 6-shifror në uebsit. Ky është faktori i dytë. Për të hyrë me sukses në llogarinë tuaj, duhet të dini edhe fjalëkalimin dhe të keni celularin për të marrë kodin/kodet unike. “Keqbërësi” nuk futet dot, sepse përveç fjalëkalimit, duhet të ketë edhe celularin tuaj. Për të qenë plotësisht të sigurt, Google ju dërgon kod unik sa herë doni të futeni në llogarinë tuaj.

Ekziston edhe një mundësi tjetër për verifikimin dyhapësh me Google apo shumë site të tjera. Në vend të kodit unik SMS, mund të instaloni në smartphone një aplikacion autentikimi, i cili gjeneron kodin unik sa herë doni të futeni në llogarinë tuaj. Dobia e kësaj metode është se nuk keni nevojë të jeni të lidhur me shërbim telefonik për të marrë kodin unik, sepse



Përdorni verifikimin dyhapësh sa më shumë, sepse është mbrojtja më e mirë e informacionit tuaj.

Verifikimi Dyhapësh

ju a gjeneron vetë celulari. Zbulimi i kodit bëhet i pamundur sepse kodi gjenerohet në nivel lokal në celularin tuaj dhe nuk ju dërgohet.

Mos harroni: verifikimi dyhapësh nuk është shërbim standard, por duhet ta aktivizoni. Në fillim duket si më shumë punë, por ju rekomandojmë fuqimisht që ta përdorni, sidomos për shërbime të rëndësishme si llogaritë e-mail, online banking apo ruajtja e skedarëve online. Verifikimi dyhapësh e mbron shumë më mirë informacionin tuaj sesa thjesht me fjalëkalime.

Mëso më shumë

Regjistrohuni në buletin tonë mujor për vetëdijësimin mbi sigurinë OUCH!, qasuni në arkivat e OUCH!, dhe mësoni më shumë mbi zgjidhjet për ngritjen e vetëdijes mbi sigurinë të ofruara nga SANS duke na vizituar në faqen

<http://www.securingthehuman.org>.

Edicioni në shqip

Edicioni në shqip i OUCH! është përkthyer nga gjuha angleze nga Ilir Bytyçi dhe Jorida Nano. Iliri është magjistër i shkencave në administrimin e rrjetave dhe sistemeve kompjuterike, është ligjërues në universitet për lëndë të ndryshme nga fusha e TI, dhe është përgjegjës për sigurinë e teknologjise informative në bankë. Jorida është përkthyesë profesioniste e gjuhës angleze në OSBE.

Burimet

Passphrases:	http://www.securingthehuman.org/ouch/2015#april2015
Sites Supporting Two-Step Verification:	https://twofactorauth.org
Stop Think Connect:	http://stopthinkconnect.org/2stepsahead
Google Two-Step Verification:	http://www.google.com/landing/2step/
SANS Security Tip of the Day:	http://www.sans.org/tip_of_the_day.php

OUCH! botohet nga SANS Securing The Human dhe shpërndahet nën licencën [Creative Commons BY-NC-ND 4.0](https://creativecommons.org/licenses/by-nc-nd/4.0/). Lejohet ta shpërndani këtë buletin ose ta përdorni për programet tuaja vetëdijësuese, për sa kohë nuk e modifikoni përmbajtjen e buletinit. Për përkthimet apo më shumë informata, ju lutemi na kontaktoni në ouch@securingthehuman.org.

Bordi editorial: Bill Wyman, Walt Scrivens, Phil Hoffman, Bob Rudis
Përkthyer nga: Ilir Bytyçi dhe Jorida Nano



securingthehuman.org/blog



[/secrethehuman](https://www.facebook.com/secrethehuman)



[@secrethehuman](https://twitter.com/secrethehuman)



[securingthehuman.org/gplus](https://www.securingthehuman.org/gplus)